



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 23 tetor 2018  
Nr. ref.: RK 1282/18

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI47/18**

Parashtrues

**Musa Grabanica dhe të tjerët**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,  
Cml. nr. 20/2017, të 30 nëntorit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë: Musa Grabanica, Isa Grabanica, Avdurrahmon Grabanica, Nazim Grabanica, Pajtim Grabanica dhe Labinot Grabanica nga Komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 20/2017, i 30 nëntorit 2017, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruar nga Prokurori i Shtetit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1053/2017, të 28 korrikut 2017 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Dega në Vushtrri, C. nr. 260/2016, të 31 janarit 2017. Parashtruesit e kërkesës aktvendimin e kontestuar e kanë pranuar më 26 dhjetor 2017.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkëlur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenet 6 [E drejta për gjykim të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 8 mars 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 14 prill 2018, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.



10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 11 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
12. Më 27 shtator 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

#### ***Lidhur me kërkesëpadinë e Musa, Isa, Avdullah, Avdurrahmon dhe Nazim Grabanica [parashtrues të kërkesës] dhe J. G.***

13. Në vitin 2014, Musa, Isa, Avdullah, Avdurrahmon dhe Nazim Grabanica [parashtrues të kërkesës] dhe J. G. në Gjykatën Themelore kishin parashtruar padi (C. nr. 472/2014) kundër N. G., përmes të cilës kishin kërkuar që të vërtetohet se N. G. i ka penguar ata në shfrytëzimin e patundshmërisë, përkatësisht një pjesë të parcelës kadastrale nr. 4430, në Zonën Komunale të Vushtrrisë.
14. Më 19 maj 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktvendimit C. nr. 51/16 refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve. Gjykata Themelore konstatoi se në këtë çështje juridike përveç objektit të kërkesës që është pengimi në posedim nuk merret me pretendimin e parashtruesve për vërtetimin e të drejtës së pronësisë. Sipas Gjykatës Themelore “*pronësia është institut i veçantë në raport me pengim posedimin, dhe aplikohen rregulla të tjera të vendosjes në atë rast*”. Në fund, Gjykata gjeti se nuk është vërtetuar se i padituri N. G. me veprimet e tij ka penguar posedimin e pjesës së paluajtshmërisë së parashtruesve.
15. Më 10 qershor 2016, kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesit paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit.

#### ***Lidhur me kërkesëpadinë e N. G.***

16. Më 22 korrik 2016, N. G. kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore, përmes të cilës kishte kërkuar që të vërtetohet se parashtruesit e kërkesës e kanë penguar atë në shfrytëzimin e patundshmërisë, përkatësisht parcelës kadastrale nr. 4430 në Zonën Komunale të Vushtrrisë.
17. Më 31 gusht 2016, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur përgjigje në padi, përmes të cilës, ndër të tjera, kishin theksuar se janë pronarë të parcelës së lartcekur dhe se të njëjtën parcelë e shfrytëzojnë me paditësin N. G. që nga ndarja e bashkësisë familjare. Parashtruesit po ashtu kanë propozuar që të hedhet poshtë padia për shkak të litispedencës (gjyqvarësisë), duke arsyetuar se e njëjta çështje është në procedurë gjyqësore sipas padisë C. nr. 472/2014, të ushtruar nga Musa, Isa, Avdullah, Avdurrahmon dhe Nazim Grabanica [parashtrues të kërkesës] dhe J. G. më 17 tetor 2014.

18. Më 31 janar 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit C. nr. 260/2016 aprovoi kërkesën e N. G., duke vërtetuar se parashtruesit e kërkesës e kanë penguar N. G. në shfrytëzimin e patundshmërisë, përkatësisht parcelës kadastrale të lartcekur. Gjykata Themelore, po ashtu, urdhëroi parashtruesit e kërkesës që të *“përmbahen nga aktet e pengimit në posedim”* dhe ju ndaloi atyre që në të ardhmen të pengojnë N. G. në shfrytëzimin e qetë të parcelës.
19. Gjykata Themelore, pas shqyrtimit të provave të prezantuara dhe shkresave të lëndës, gjeti se N. G. para se të pengohet nga parashtruesit kishte poseduar parcelën, e cila kishte qenë e mbjellë me të mira bujqësore. Në vijim, Gjykata po ashtu konstatoi se *“ka qenë irelevante çështja e ngritur nga të paditurit [parashtruesit] se pronë e kujt është parcela në fjalë”*. Ndërsa, sa i përket propozimit të parashtruesve që ta hedhë poshtë padinë e N. G. për shkak të litispedencës (gjqvarësisë), Gjykata konstatoi se nuk ishin plotësuar kriteret ligjore në bazë të nenit 262 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), *“ngase nuk përputhet as objekti i kërkesës dhe palët janë me pretendime të kundërta”*.
20. Në një datë të pasaktësuar, kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore të 31 janarit 2017, parashtruesit paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit.
21. Më 28 korrik 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac. nr. 1053/2017, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 260/2016, të 31 janarit 2017.
22. Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë bazuar në provat dhe gjendjen faktike drejtë konstatoi se është kryer pengimi i posedimit nga ana e parashtruesve. Më tej, po ashtu edhe Gjykata e Apelit, duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore vërtetoi se parashtruesit e kanë penguar paditësin N. G. në shfrytëzimin e patundshmërisë.
23. Më 6 shtator 2017, parashtruesit e kërkesës paraqitën propozim për ushtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, të 28 korrikut 2017.
24. Në propozimin e tyre parashtruesit, së pari, pretenduan shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se kontesti lidhur me pengim posedimin për të njëjtën paluajtshmëri të parashtruar nga ata është në zhvillim e sipër. Së dyti, parashtruesit pretenduan se e tërë ngastra kadastrale nr. 4430 është shpronësuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin 06/160 të 11 dhjetorit 2013. Së treti, parashtruesit pretenduan se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë vendimin e saj pa pjesëmarrjen e ekspertit të gjeodezisë. Së fundi, parashtruesit pretenduan se ata nuk janë njoftuar nga gjykata e shkallës së parë kur është realizuar dalja në vend të ngjarjes.
25. Më 11 shtator 2017, Zyra e Prokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KMLC. nr. 104/2017, njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesve se kishte miratuar propozimin e parashtruesve dhe se të njëjtën datë kishte paraqitur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1053/17, të 28 korrikut 2017.



26. Më 30 nëntor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit Cml. nr. 20/2017 refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori i Shtetit.
27. Gjykata Supreme gjeti se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori i Shtetit nuk ka plotësuar kriteret e nenit 247, paragrafi 1, nën paragrafi a) të LPK-së. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme arsyetoi se Prokurori i Shtetit mund të paraqes kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në qoftë se shkelja ka të bëjë “[...] me kompetencën territoriale, po që se gjykata e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse ka pasur detyrë të mbajë seancë kryesore, po që se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontesti është në vazhdim apo në qoftë se në kundërshtim me Ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore”.
28. Sa i përket pretendimit të parashtruesve për gjyqvarësi, Gjykata Supreme përkitazi me identitetin e palëve gjeti se në padinë e dytë si paditës janë paraqitur edhe dy paditës tjerë, përkatësisht Rexhep Grabanica dhe Labinot (Musa) Grabanica, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në kontestin e parë. Ndërsa në kontestin e dytë nuk kishte qenë i përfshirë J.G., i cili kishte qenë palë në kontestin e parë. Përkitazi me identitetin e objektit, Gjykata Supreme gjeti se në kontestin e parë, parashtruesit kishin kërkuar vërtetimin e pengim posedimit të një pjese të ngastrës kadastrale nga ana e N. G., ndërsa në kontestin e dytë, objekt shqyrtimi kishte qenë e tërë ngastra kadastrale nr. 4430. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme përfundoi se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjyqvarësi, ashtu siç është pretenduar nga parashtruesit e kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 [E drejta për gjykim të rregullt] të KEDNJ-së dhe 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
30. Parashtruesit e kërkesës, në veçanti, pohojnë se kërkesëpapia e parashtruar nga ata në vitin 2014 lidhur me pengim posedimin për të njëjtën paluajtshmëri është në procedurë para Gjykatës së Apelit.
31. Në lidhje me këtë, parashtruesit pretendojnë se konstatimi i Gjykatës Supreme se në rastin konkret nuk janë plotësuar kriteret e përcaktuara me LPK përkitazi me gjyqvarësinë (litispedencën) është i padrejtë. Përkitazi me identitetin e palëve, parashtruesit pohojnë se “[...] në padinë e dytë ne nuk jemi paditës por të paditur dhe se Rexhep Grabanica ka vdekur me datë 13.02.2010 dhe ka qenë baba jonë kurse Labinot (Musa) Grabanica është fëmija jonë që ka ndihmuar me punë. Andaj nuk qëndron ky konstatim i Gjykatës Supreme”. Ndërsa përkitazi me identitetin e objektit, parashtruesit pohojnë se në rastin konkret kemi të bëjmë me paluajtshmërinë e njëjtë, dhe “Gjithashtu edhe sipërfaqja e kontestit është e njëjtë dhe vendi i njëjtë në të dy rastet por në të parin e ka konstatuar eksperti”.
32. Së dyti, parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me konstatimin e gjendjes faktike, duke pohuar se nuk qëndron fakti se paditësi, përkatësisht N. G. e ka poseduar

paluajtshmërinë “[...] e cila ka qenë e mbjellë me grurë”. Sipas pretendimeve të parashtruesve “[...] kemi të bëjë me tërshërë (50 ari pjesa e sipërme e parc.) e jo me grurë si thotë paditësi [N. G]”.

33. Së treti, parashtruesit po ashtu sërish pohojnë se ata nuk janë njoftuar nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht Gjykata Themelore, kur është realizuar dalja në vend të ngjarjes.
34. Në fund, parashtruesit e kërkesës theksojnë se prona e tyre, përkatësisht parcela e lartcekur, është shpronësuar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 06/160, të 11 dhjetorit 2013 “[...] për nevoja të ndërtimit të rrugës nacionale N2 segmenti Prishtinë-Mitrovicë”.

### **Dispozitat relevante ligjore**

#### ***Ekzistimi i gjyqvarësisë (Litispendenca)***

##### ***Neni 262***

*262.1 Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia.*

*262.2 Sa i përket kërkesës të cilën pala e ka parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtare për kërkesën e tillë.*

*262.3 Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë.*

*262.4 Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.*

##### ***Neni 263***

*263.1 Në qoftë se ndonjëra nga palët e tjetërson, gjatë zhvillimit të procedurës sendin apo të drejtën e kërkuar me padi, një gjë e tillë nuk pengon që procedimi të përfundojë midis palëve të njëjta.*

*263.2 Personi që e ka fituar sendin apo të drejtën gjatë zhvillimit të gjykimit mund të hyjë në procedurë, në vend të paditësit apo të paditurit, vetëm me pëlqimin e të dy palëve ndërgjyqëse.*

*263.3 Në rastin e paragrafit 1 të këtij neni aktgjykimi prodhon efekt edhe ndaj fituesit të sendit apo të drejtës gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*



[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

37. Gjykata vëren se parashtruesit janë palë e autorizuar në pajtim me Kushtetutën, kanë shteruar të gjitha mjetet e nevojshme juridike, si dhe kanë dorëzuar kërkesën e tyre brenda afatit 4 (katër) mujor pas pranimit të aktvendimit.
38. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*
39. Gjykata po ashtu rikujton rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën e papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
40. Fillimisht, Gjykata vë në pah se kontesti për pengim posedim të paluajtshmërisë, i iniciuar në vitin 2014 nga Musa, Isa, Avdullah, Avdurrahmon dhe Nazim Grabanica [parashtrues të kërkesës] dhe J. G., sipas shkresave të lëndës, është në procedurë pranë Gjykatës së Apelit. Sidoqoftë, kjo procedurë nuk është pjesë e objektit të çështjes së kërkesës së parashtruesve.
41. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përmes të cilit është refuzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1053/2017, të 28 korrikut 2017 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, C. nr. 260/2016, të 31 janarit 2017.
42. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë që aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 [E drejta për gjykim të rregullt] të KEDNJ-së dhe 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
43. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë vendosur përkitazi me këtë rast përderisa sipas tyre pranë Gjykatës së Apelit është duke u zhvilluar procedura gjyqësore sipas padisë së tyre të parashtruar në vitin 2014. Në mënyrë specifike, parashtruesit pohojnë se në rastin konkret kemi të bëjmë me palët e njëjta dhe objektin e njëjtë të kontestit.
44. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit të saj, C. nr. 260/2016, të 31 janarit 2017 konstatoi:



*“Sa i përket propozimit që gjykata ta hedh padinë për shkak të litispendencës, një pretendim të tillë gjykata e gjeti si të pabazuar nga se nuk plotësohen kriteret ligjore për një gjë të tillë të paraparë në nenin 262 të LPK-së ngase nuk përputhet as objekti i kërkesës dhe palët janë me pretendime të kundërta”.*

45. Këtë konstatim të Gjykatës Themelore e ka vërtetuar Gjykata e Apelit edhe Gjykata Supreme, e cila në mënyrë të detajuar ka arsyetuar dhe po ashtu ka adresuar pretendimin e parashtruesve përkitazi me gjyqvarësinë të paraqitur në propozimin e tyre për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme thekson se *“Krijimi i gjyqvarësisë si pasojë procedurale juridike është paraparë me dispozitën e nenit 262, par. 3 të LPK-së. Nëse një çështje ose jo në kuptim të kësaj norme është e gjykuar varet nga dy rrethana: nëse palët dhe objekti i kontestit në procedurën e re është identike me palët dhe objektin e kontestit në procedurën paraprake. Këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë komulative në mënyrë që të vijë në shprehje zbatimi i dispozitës së nenit 262 par. 3 të LPK-së. Identiteti i palëve ekziston atëherë kur edhe në procesin e ri paraqiten si subjekt palët e njëjta, ndërkaq identiteti objektiv ekziston atëherë, kur objekti i kontestit është i njëjtë në të dy paditë”.*
46. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme përkitazi me identitetin e palëve gjeti se në padinë e dytë si paditës janë paraqitur edhe dy paditës tjerë, përkatësisht Rexhep Grabanica dhe Labinot (Musa) Grabanica, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në kontestin e parë. Ndërsa në kontestin e dytë nuk kishte qenë i përfshirë J. G., i cili kishte qenë palë në kontestin e parë. Përkitazi me identitetin e objektit, Gjykata Supreme gjeti se në kontestin e parë, parashtruesit kishin kërkuar vërtetimin e pengim posedimit të një pjese të ngastrës kadastrale nga ana e N. G., ndërsa në kontestin e dytë, objekt shqyrtimi kishte qenë e tërë ngastra kadastrale nr. 4430. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme përfundoi *“[...] në këtë çështje nuk kemi të bëjmë me identitetin e palëve dhe objektit të kontestit, kjo nënkupton se në rastin konkret nuk kemi gjyqvarësi ashtu siç pa bazë theksohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë”.*
47. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesit nuk pajtohen me konstatimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e rregullta, në veçanti Gjykata Themelore.
48. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
49. Në vijim, Gjykata vëren se parashtruesit pohojnë se paluajtshmëria, e cila është objekt i çështjes në aktvendimet e kontestuara, është shpronësuar me Vendim të Qeverisë të 11 dhjetorit 2013. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit nuk arsyetojnë apo mbështesin se si çështja e shpronësimit ndikon në vendimet e



kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat kanë konstatuar pengimin në posedim nga ana e parashtruesve.

50. Si përfundim, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, si dhe vetëm përmendja e neneve përkatëse të Kushtetutës pa shtjelluar shkeljen e pretenduar të tyre, nuk është e mjaftueshme që parashtruesit e kërkesës të ndërtojnë një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
51. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar dhe nuk kanë mbështetur pretendimet e tyre se si procedurat e përfunduara në gjykatat e rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e vendimeve të këtyre gjykatave.
52. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata përfundon se parashtruesit nuk dëshmojnë dhe nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre për shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës së tyre në pronë të garantuar me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
53. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 te Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, me 27 shtator 2018, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën te papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim ne Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Bekim Sejdiu



**Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi